

**DREJTORIA E TENSIONIT TE LARTE
DEGA E SHERBIMEVE MBESHTESE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më /05/2021

Lënda : Njoftimi i fituesit , i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Drejtuar: **AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**

Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data 17.05.2021

Për OE: {**EL - POWER**} Sh.p.k_ me adresë: Tiranë Njesia Administrative Nr.5, Rruga Bulevardi Bajram Curri, Ndërtesa Nr.130, Hyrja 3, Ap.38, 1019, **me Nr. Nipti L12009008K**, e përfaqësuar nga Administratori i saj Z. Elton MATAJ.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur-Mallra

Numri i referencës së procedurës: REF-91197-03-25-2021.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Elemente për mirëmbajtje të qarqeve sekondare për N/stacioneve”**, me fondin limit 149,961,000 (njëqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një mijë) lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga të ardhurat e OSSH sh.a”, zëri i investimeve 2021 dhe me afat realizimi **4 (katër) muaj, nga nënshkrimi i kontratës.**

Publikime të mëparshme (X): Buletini i Njoftimeve Publike *Data* 26.03.2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë ofertuesit (OE) në konkurim me vlerë përkatëse të ofruar si më poshtë vijon:

Emërtimi i Shoqërive pjesmarrëse:

**DREJTORIA E TENSIONIT TE LARTE
DEGA E SHERBIMEVE MBESHTETESE**

NR	Emërtimi i Shoqërive	Oferta në lekë pa TVSH
1	BOE: “DABAR” shpk L62409033I & “ILIRIADA” shpk me Nr. Nipti J61828125L.	131,930,000
2	OE: “EL - POWER” shpk me Nr. Nipti L12009008K.	148,625,000.00

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

BOE: “DABAR” shpk & “ILIRIADA” shpk me Nr. Nipti L62409033I & J61828125L.

- A. Komisioni procedoi me tej me shqyrtimin e dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik si më poshtë: BOE: “DABAR” shpk me Nr. Nipti L62409033I & “ILIRIADA” shpk me Nr. Nipti J61828125L gjate shqyrtimit te dokumentacionit, komisioni i vlersimit te ofertave konstatoi mungesen e dokumentacionit si me poshte vijon:**

Vlera totale e ofertes pa tvsh = 131.930.000 lekë dhe Vlera totale e ofertës me tvsh = 158.316.000 me tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky BOE, nga ku rezultoi si më poshtë:

➤ Në piken 1/d ne kriteret e pergjithshme te pranimit është kërkuar *“Ofertuesi duhet te deklaroje se ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi”*.

Shoqeria “Iliriada” Shpk ka deklaruar ne deklaraten mbi permbushjen e kriterëve te pergjithshme se ka paguar detyrimet ne fjale sipas legjislacionit ne fuqi, nderkohe rezulton si vijon:

DREJTORIA E TENSIONIT TE LARTE DEGA E SHERBIMEVE MBESHTETESE

- Per Z. Joani Kapo, inxhinier elektrik, paga sipas kontrates se punes : 180.000 leke, nderkohe, ne listapagesat Tetor 2020 – Mars 2020, rezulton me page 100.000 leke.

Sa me siper, OE “Iliriada” Shpk ka vepruar ne kundershtim me pikën 2/d të nenit 45 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës”**.

Ne keto kushte, kjo shoqeri ndodhet ne kushtet e parashikuara ne nenin 13/3 te LPP, pasi ka *paraqitur dokumentacion që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, pasi* ne deklaraten mbi përmbushjen e kriterëve te pergjithshme ka deklaruar shlyerjen e detyrimeve ne fjale sipas legjislacionit ne fuqi.

- Në kriteret e pergjithshme te pranimit është kërkuar *“Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarish”*.

Sipar marreveshjes se bashkepunimit, shoqeria “Dabar” Shpk ka marre persiper 70% të punimeve dhe “Iliriada” Shpk 30%, nderkohe, sipas ofertes se paraqitur nga ky BOE: vlera e punimeve te marre persiper nga shoqeria “Dabar” Shpk eshte 91.74 milion leke ose 69.51 % dhe jo 70 % sikurse cilesohet ne marreveshjen e bashkepunimit. Gjithashtu, vlera e punimeve te marre persiper nga “Iliriada” Shpk eshte 40.19 milion leke ose 30.46 % dhe jo 30% sikurse cilesohet ne marreveshjen e bashkepunimit.

Kjo mosperputhje eshte ne kundershtim me nenin 74/ te te VKM-se Nr.914,date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, I ndryshuar ku percaktohet se: *“ Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*.

- Në pikën 2.34. të kriterëve të vecantë të pranimit, është kërkuar: *“4. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera per mallrat e ofertuar, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.*

VO: Te gjitha dokumentat e mesiperme nese nuk jane ne gjuhen shqipe duhet te shoqerohen me perkthimet perkatese dhe noterizim.

- **Ne testraporte per Panelet (Avr) konsatohet si vijon:**

DREJTORIA E TENSIONIT TE LARTE DEGA E SHERBIMEVE MBESHTETESE

- Test Raporti No. 42563/04.06.2010
Ne piken 8 te testraportit thuhet se: ky test ka 5 flete, nderkohe jane perkthyer vetem 3 fletet e para.
- Test Raporti No. 1576/04.06.2010
Ne piken 8 te testraportit thuhet se: ky test ka 5 flete, nderkohe eshte perkthyer vetem fleta e parë.
- Test Raporti No. 20103/03.06.2010
Ne piken 7 te testraportit thuhet se: ky test ka 9 flete, nderkohe eshte perkthyer vetem fleta e parë.

Sa me siper, dokumentacioni I paraqitur eshte ne kundershitim me kriterein e sipercituar dhe kundershitim me nenin 14/2 te VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “*Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe*”.

- Gjithashtu, te gjithë test-raportet **per transformatoret e rrymes** jane ne gjuhe te huaj dhe pa perkthim.

Per me teper keto test-raporte (per *transformatoret e rrymes*) jane te gjitha me afat vlefshmerie te skaduar:

- Test Raporti No. 150059G Temperature – rise test: **validy: maksimumi 25.04.2016** (faqe 15 e dokumentit).
- Test Raporti No. 150059G Radio interference voltage test circuit: **validy: maksimumi 25.04.2016** (faqe 22 e dokumentit).
- Test Raporti No. 150059G Radio interference voltage test : **validy: maksimumi 24.04.2016** (faqe 24 e dokumentit).
- Test Raporti No. 150059G Power frequency withstand voltage test circuit: **validy: maksimumi 25.04.2016** (faqe 50 e dokumentit).

Keto teste jane bere ne periduhën kohore nga 22.05.2015 deri 31.07.2015.

Gjithashtu, po ne kete file (**Test_raport_per_transformator_rryme_1**) gjendet edhe “Inspection report), I cili eshte ne anglisht dhe I paperkthyer, ku cilesohet se data e inspektimit nga 26.07.2012-01.08.2012 dhe koha e vlefshme (valid time) 5 vjet, Pra edhe ky raport eshte I pavlefshem, cka ben qe te gjithë testraportet e ketij file te jene te pavlefshem.

Edhe test-raportet No. 150059G ne file (**Test_raport_per_transformator_rryme**) jane me te njejtat afate vlefshmerie si dhe me siper.

DREJTORIA E TENSIONIT TE LARTE DEGA E SHERBIMEVE MBESHTETESE

- Te gjithë test-raportet per *transformatorët e tensionit* janë ne gjuhe te huaj dhe pa perkthim.

Gjithashtu, po ne kete file (**Test_raport_per_tranformator_tensioni.pdf**) gjendet edhe “Inspection report), I cili eshte ne anglisht dhe I paperkthyer, ku cilesohet se data e inspektimit nga 26.07.2012-01.08.2012 dhe koha e vlefshme (valid time) 5 vjet, Pra edhe ky raport eshte I pavlefshem, cka ben qe te gjithë test - raportet e ketij file te jene te pavlefshem.

Edhe test-raportet file (**Test_raport_per_tranformator_tensioni_2.pdf**) janë ne anglisht dhe te paperkthyer.

Sqarojmë se në pikën 1 te Ligjit 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, citohet sa me poshte: **Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.**

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së **BOE: “DABAR” shpk me Nr. Nipti L62409033I & “ILIRIADA” shpk me Nr. Nipti J61828125L** në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE: **“EL POWER” shpk me Nr. Nipti L12009008K” sh.p.k** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 148.625.000.00 (njëqind e dyzet e tetë milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë) *lekë* pa TVSH.

Pikët totale të marra [100] jështë identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtoria e Tensionit te Lartë OSSH sha, Rr. “Gramoz Pashko”, Vila Gri,Tiranë,Shqipëri., sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 58 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2007 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 07.05.2021

**DREJTORIA E TENSIONIT TE LARTE
DEGA E SHERBIMEVE MBESHTETESE**

Ankesa: ka ose jo: JO